



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:248466

Datë: 04.11.2023

Numri i dokumentit: 04875617

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.861/21

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnje në çështjen penale kundër të pandehurit D. Sh. nga Peja, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2080/21 të datës 04.11.2021, për shkak të veprës penale Kanosje në vazhdimësi nga neni 181 par.2 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 18.10.2023 në prezencë të prokurores së shtetit Sadije Muriqi dhe të pandehurit D. Sh. , të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa me datë 04.11.2023 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

D. SH. , i lindur me, në K., komuna Klinë, i biri i Xh. dhe nënës R., e gjinisë B., me vendbanim në V., rr:" S.N.", pa nr. punon në ndërtimtari, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

- I. Me datën 19.06.2021 rreth orës 13:30, në fshatin V. K-Pejë, me qëllim të frikësimit, me fjalë e kanos tjetrin se do t'i shkaktojë ndonjë të keqe dhe atë të dëmtuarin A. R., në atë mënyrë që, ditën kritike derisa i dëmtuari po qarkullonte me veturën e tij të markës B., me të arritur në rrugën "S. N." i pandehuri D.i bënë me shenjë me dorë që të ndalet dhe pasi që i dëmtuari ndalet dhe në momentin kur del nga vetura e tij aty i afrohet i pandehuri dhe në mes tyre fillon konflikti verbal lidhur me të dashurën e të dëmtuarit, M. M., për çka i pandehuri i drejtohet me fjalë kërcënuese "Unë ty kam me të prerë nga koka deri te thembra ", ku tek i dëmtuari shkakton frikë.

-me çka ka kryer vepër penale “Kanosje” nga neni 181 par. 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

- II.** Me datën 19.06.2021 rreth orës 13:40, në fshatin V. , reoni II,K-Pejë me qëllim të frikësimit, me fjalë e kanos tjetrin se do t’i shkaktojë ndonjë të keqe dhe atë të dëmtuarin E. R., në atë mënyrë që ditën kritike, pasi që i dëmtuari E. njoftohet përmes telefonit nga djali i tij A., (i dëmtuar sipas dispozitivit të parë), se në lokacionin e caktuar është duke e kanosur i pandehuri D., i njëjti shkon menjëherë me veturë në vendin e lartcekur ku aty e takon djalin e tij dhe të pandehurin D.i cili menjëherë nisët në drejtim të dëmtuarit E. dhe derisa ky i fundit tenton që të bisedoj me të për arsyen e ndaljes dhe kërcënimit ndaj djalit të tij, i pandehuri duke iu afruar te fytyra i drejtohet me fjalë kanosëse “Unë e di se ku jetoni , kam me ardhur te shtëpia që ta vras krejt familjen tuaj” duke shkaktuar frikë tek i dëmtuari.

-me çka ka kryer vepër penale “Kanosje” nga neni 181 par. 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69,70 dhe 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit D. Sh. i shqipton, për vepër penale ne vazhdim:

- I.** DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Obligohet i dënuari qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- III.** Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga pala e dëmtuar.

ARSYETIM

Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 04.11.2021 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2080/21 kundër të pandehurit D. Sh. për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 18.10.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Sadije Muriqi dhe i pandehuri D. Sh. i, në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe në kuptim të nenit 322 lidhur me nenin 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi “Me qenë se në rastin konkret kemi edhe pranimin e fajësisë që gjënë mbështetje ë prova materiale po ashtu në rastin konkret kemi dy të dëmtuar, ku për këtë vepër është plotësuar kusht themelor tek të cilat ka shkaktuar frikë sipas deklaratave të dhëna në fazën e hetimeve, kërkoj nga gjykata që këtë ta merr si rrethana rënduese me rastin shpalljes së vendimit përfundimtare, ndërsa rrethanat lehtësuese ja lë në vlerësim të gjykatës”.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, i pandehuri D. Sh. deklaroi “ Me vjen shumë keq që ka ndodhë ky rast, unë nuk kam dashtë me ndodh sepse ktu të dëmtuarit as nuk i kam njohur me herët, kjo thjeshtë ka eskaluar në qastë – moment, pasi që A. mu ka ndal përpara, andaj edhe një herë po e them me vjen shumë keq dhe shprehi keqardhje”.

Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69,70 dhe 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe rënduese te çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit D. Sh. do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej një (1) viti do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua më lartë për veprën penale që është shpallur fajtor i pandehuri është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

I pandehuri është shpallur fajtor për vepër penale Kanosje nga neni 181 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, e cila vepër realisht është e kryer përmes dy veprave penale si të veçanta,

përkatësisht i pandehuri me ndërmarrjen e disa veprimeve të ndara i ka kryer dy vepra penale me dy të dëmtuar, mirëpo gjykata të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim për vepër penale në vazhdim dhe atë në kuptim të nenit 77 par.1 të KPRK-së.

Vendimi i gjykatës për shqiptimin e dënimit për vepër penale në vazhdim mbështetet në faktin se gjykata gjeti lidhshmëri kohore ndërmjet veprave penale për të cilat është shpallur fajtor i pandehuri dhe se veprimet e kryerjes të shprehura përmes paralajmërimit se do të shkaktoj një të keqe të dëmtuarve, paraqesin një tersi veprimesh të ndërlidhura me njëra tjetrën si në aspektin objektiv ashtu në aspektin kohor.

Gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit janë shprehur edhe elemente të tjera të cilat e formësojnë veprën penale në vazhdim, e që janë objekti i njëjtë i veprës penale që ka të bëjë me të mirë në mbrojtur përkatësisht faktin se objekt i këtyre veprave penale është jeta dhe trupi, dashja e njëjtë e kryerësit dhe shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore, pasi që në të dyja veprat penale kanë lidhshmëri të ngushtë me njëra tjetrën.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit D. Sh. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte të parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal

P.nr.861/21, me datë 04.11.2023

Procesmbajtësja:
Shpresa Kërnje

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.